

## UDHËZUES

# PËR PËRMIRËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT, SI PASOJË E SITUATËS SË KRIJUAR NGA PANDEMIJA COVID-19

### LËNDËT

“GJUHË SHQIPE”,  
“MATEMATIKË” DHE  
“GJUHË E HUAJ E PARË”

**Klasat  
VI-IX**

(Në ndihmë të drejtuesve dhe të mësuesve të shkollave 9-vjeçare)

GUSHT  
2021



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**Udhëzues**

**për përmirësimin e arritjeve të nxënësve**

**në arsimin e mesëm të ulët, si pasojë e situatës së krijuar nga  
pandemia COVID-19**

**LËNDËT:**

**“GJUHË SHQIPE”, “MATEMATIKË” DHE “GJUHË E HUAJ E PARË”**

**(Në ndihmë të drejtuesve dhe të mësuesve të shkollave 9-vjeçare)**

**GUSHT 2021**

Udhëzues për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19

Lëndët : “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj e parë”

**GUSHT 2021**

**Tiranë**

**© Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)**

# TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES .....	3
HYRJE.....	4
KUSHTET PËR ZBATIMIN E UDHËZUESIT.....	7
2.1 Periudha e zhvillimit të temave të përsëritjes .....	7
2.2 Fleksibiliteti i mësuesit për zhvillimin e temave të përsëritjes.....	8
2.3 Mjediset.....	9
2.4 Numri i nxënësve për klasë .....	9
2.5 Mjetet mësimore .....	9
2.6 Bashkëpunimi me prindërit .....	9
2.7 Temat e përsëritjes për nxënësit me aftësi të kufizuar .....	10
2.8 Pagesa për mësuesit e gjuhës shqipe, matematikës dhe gjuhës së huaj të parë 10	
2.9 Monitorimi dhe raportimi i procesit të përsëritjes nga drejtoria e shkollës.....	10
KRIJIMI I KLIMËS MBËSHTETËSE DHE BASHKËPUNUESE ME NXËNËSIT .....	12
METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E TEMAVE MËSIMORE PËR PËRSËRITJE.....	14
FREKUENTIMI DHE VLERËSIMI I NXËNËSVE PËR TEMAT E PËRSËRITJES .....	15
5.1 Frekuentimi i nxënësve.....	15
5.2 Vlerësimi i nxënësve.....	15
5.3 Dokumentacioni për zhvillimin e temave të përsëritjes .....	15
TEMAT MËSIMORE TË PËRSËRITJES PËR SECILËN KLASË DHE LËNDË.....	16
6.1 Klasa e gjashtë.....	16
6.2 Klasa e shtatë.....	19
6.3 Klasa e tetë .....	22
6.4 Klasa e nëntë .....	24
PLANIFIKIMI I KURRIKULËS PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022.....	28

Pandemia COVID-19 ndryshoi brenda një kohe të shkurtër pothuajse çdo aspekt të shkollës. Nuk ishte vetëm lëvizja e nxënësve nga klasat në ekranet e kompjuterëve, por ndryshoi edhe mësimdhënia, procesi i të nxënësve, vlerësimi i nxënësve, roli i teknologjisë në mësimdhënie etj. Pavarësisht se si do të vijojë situata epidemiologjike, disa nga këto ndryshime mund të zgjasin, prandaj është shumë e rëndësishme që edhe në këto kushte të vijojë përmirësimi i shërbimit arsimor në mënyrë që fëmijët të marrin maksimumin prej tij.

Vitin e kaluar shkollor, mësimi u zhvillua sipas tri skenarëve (në shkollë, i kombinuar dhe online). Falë angazhimit të mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave u arrit që të përfundonte i plotë procesi mësimor. Puna dhe përpjekjet e tyre në këtë kohë të pasigurt, përshtatja me përdorimin e rrugëve dhe të formave të reja në procesin e të nxënësve, mbështetja që i dhanë njëri-tjetrit dhe gatishmëria për të bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), si dhe me të gjitha institucionet që kanë në fokus të tyre, arsimin parauniversitar, është për t'u falënderuar.

Në këto përpjekje shkollat u mbështetën nga MASR dhe ASCAP nëpërmjet:

- hartimit të udhëzuesve në ndihmë të mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave;
- ofrimit të mësimëve të xhiruara dhe të transmetuara në RTSH Shkolla;
- ofrimit të platformës akademi.al për mësimin online;
- përmirësimit të shërbimit psikologjik;
- realizimit të trajnimeve për zhvillimin e aftësive digjitale të mësuesve;
- ofrimit të pajisjeve digjitale për nxënësit në nevojë;
- etj.

Pavarësisht angazhimit të të gjithë “aktorëve” në arsim, si në çdo vend tjetër edhe në vendin tonë, mësimi online i përballi me vështirësi nxënësit në shkolla e rajone të ndryshme. Për të evidentuar nevojat për përmirësim të këtyre nxënësve dhe duke u

bazuar në shkresën nr.2483 prot., datë 30.04.2021 e MASR-së “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve me qëllim identifikimin e nevojave për përmirësim, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19”:

- u hartuan nga ASCAP programet orientuese për vlerësimin e arritjeve të nxënësve;
- u hartuan testet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), ndërsa procesi i vlerësimit u koordinua nga ZVA-të dhe DRAP-et. Në arsimin e mesëm të ulët (AMU) nxënësit u testuan në lëndët kryesore: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Gjuhë e huaj, të cilat janë edhe lëndët e provimeve kombëtare të arsimit bazë;
- u hartua nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) raporti i nevojave për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

Nga veprimtaritë e mësipërme u identifikuan vështirësitë dhe mangësitë e nxënësve në lëndët kryesore, të cilat diktojnë nevojën e përsëritjes, përforcimit dhe përmirësimit të rezultateve të nxënësve në AMU. Për të orientuar drejtuesit e shkollave dhe mësuesit rreth këtij procesi është hartuar *Udhëzuesi për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët, si pasojë e situatës COVID-19*. Udhëzuesi sqaron drejtuesit e shkollave dhe mësuesit në lidhje me:

- Periudhën e zhvillimit të temave mësimore për përsëritje;
- Fleksibilitetin e mësuesit për zhvillimin e temave të përsëritjes;
- Mjediset, numri i nxënësve për klasë, mjetet mësimore për zhvillimin e temave të përsëritjes;
- Bashkëpunimin me prindërit;
- Krijimin e klimës mbështetëse dhe inkurajuese për nxënësit gjatë zhvillimit të temave të përsëritjes;
- Metodologjinë që mund të ndiqet nga mësuesit gjatë zhvillimit të temave të përsëritjes;
- Mjetet mësimore që mund të përdoren nga nxënësit dhe nga mësuesit;
- Frekuentimin dhe vlerësimin e nxënësve gjatë zhvillimit të temave të përsëritjes;
- Dokumentacionin që mësuesit mund të mbajnë për arritjet e nxënësve dhe për frekuentimin e tyre gjatë zhvillimit të temave të përsëritjes;
- Planifikimin e kurrikulës për vitin shkollor 2021-2022;
- Temat e përsëritjes për secilën klasë dhe lëndë.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e situatës që ka krijuar pandemia COVID-19, ky udhëzues synon jo vetëm të orientojë shkollat, por edhe t'u japë liri dhe fleksibilitet në lidhje me zbatimin e temave të përsëritjes në varësi të kontekstit dhe të rrethanave të tyre.

# KUSHTET PËR ZBATIMIN E UDHËZUESIT

## 2

Fillimi i vitit shkollor është zakonisht një kohë emocionesh të ndryshme për nxënësit: entuziazëm për të parë shokët, shoqet dhe mësuesit pas muajsh larg, kuriozitet për klasat e reja ose për shokët e rinj dhe kënaqësi për kthimin në shkollë. Këtë vit shkollor, nxënësit do të vijnë në shkollë edhe më të ndjeshëm pasi të gjitha problematikat që ka krijuar pandemia COVID-19, i kanë prekur edhe ata.

Me informacionin dhe statistikat e koronavirusit që përditësohen vazhdimisht dhe ndërsa një vit i ri shkollor do të fillojë, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 për vitin që vjen, pyetja që lind është: *Cilat masa paraprake duhet të merren në mënyrë që të plotësohen mangësitë dhe vështirësitë e nxënësve nga viti i kaluar dhe të sigurohet realizimi i procesit mësimor dhe mbështetja e nxënësve në shkollë?*

Një përgjigje e kësaj pyetjeje është edhe hartimi i temave të përsëritjes, të cilat synojnë t'u mundësojnë nxënësve që për një periudhë rreth 4- javore, dhe jo vetëm, të përsërisin, të përforcojnë apo të përmirësojnë rezultatet e tyre lidhur me mangësitë e identifikuar, por edhe të përshtaten me rregullat e reja.

### 2.1 Periudha e zhvillimit të temave të përsëritjes

Temat e përsëritjes do të zhvillohen gjatë periudhës 01- 24 shtator 2021. Në çdo klasë të AMU-së, përgjatë kësaj periudhe do të zhvillohen gjithsej 48 orë mësimore sipas planit mësimor javor të arsimit bazë. Nga këto:

- 20 orë mësimi janë për lëndën e gjuhës shqipe;
- 16 orë mësimi janë për lëndën e matematikës;
- 12 orë mësimi janë për lëndën e gjuhës së huaj.



Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me mësuesit e gjuhës shqipe, matematikës dhe gjuhës së huaj të parë, harton një orar paraprak për zhvillimin e temave të përsëritjes në këto lëndë (jo më shumë se 3 orë mësimore në ditë). Ora e mësimit për temat e përsëritjes është 45 minuta. Orari mund të organizohet me dy orë të njëpasnjëshme.

Temat e përsëritjes do të zhvillohen në formën e konsultimeve dhe do të lidhen me nevojat e identifikuara gjatë vlerësimit të arritjeve të nxënësve, si dhe me njohuritë kryesore të vitit shkollor 2020-2021.

Procesi mësimor për përsëritjen mund të fillojë në orën 8.30. Drejtoria e shkollës mund ta spostojë këtë orar në varësi të specifikave dhe të rrethanave që ka shkolla (p.sh., largësia shkollë - shtëpi e nxënësve).

Gjatë kësaj periudhe, përveç mësimit plotësues, shkolla mund të zhvillojë edhe veprimtari artistike dhe sportive, për realizimin e të cilave angazhohen mësuesit e lëndëve të tjera (mësuesit e lëndëve që nuk zhvillojnë përsëritje). Zhvillimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas një plani të hartuar në nivel shkolle, i cili miratohet nga drejtoria e saj.

## **2.2 Fleksibiliteti i mësuesit për zhvillimin e temave të përsëritjes**

Është e rëndësishme të theksojmë që mësuesit janë të lirë dhe fleksibël të përshtatin apo të ndryshojnë temat e përsëritjes sipas nevojave dhe interesave të nxënësve, specifikave të lëndës dhe situatës që ka kaluar secila shkollë në zhvillimin e procesit mësimor gjatë vitit shkollor 2020 – 2021. Kjo nënkupton që mësuesit mund t'i zëvendësojnë këto tema me tema të tjera të së njëjtës klasë, për të cilat nxënësit paraqesin më shumë mangësi apo kanë më shumë nevojë për përmirësimin e rezultateve nga vitit i kaluar shkollor 2020 – 2021.

Sugjerohet që orët e përsëritjes të zhvillohen nga mësuesit, të cilët nxënësit i kanë pasur gjatë vitit të kaluar shkollor.

## 2.3 Mjediset

Për zbatimin e temave të përsëritjes do të përdoren klasat e shkollës ose edhe mjedise të tjera në shkollë, sipas specifikave të temave mësimore. Në varësi të situatës së pandemisë COVID-19 do të bëhet edhe rregullimi ose përshtatja e mjedisit të klasave.

Para se të fillojë zbatimi i temave të përsëritjes dhe në varësi të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, shkolla mund të përditësojë një rregullore të thjeshtë dhe të kuptueshme për nxënësit mbi masat e distancimit fizik dhe praktikatat e higjienës.

## 2.4 Numri i nxënësve për klasë

Nxënësit janë të lirë të ndjekin orët për temat e përsëritjes për lëndët “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj e parë”. Në varësi të numrit të nxënësve, drejtorët e shkollave përcaktojnë ndarjen e klasave që do të zhvillojnë temat e përsëritjes. Mësuesit do të zhvillojnë temat e përsëritjes me aq nxënës sa frekuentojnë këto orë përsëritjeje ose përforcimi.

## 2.5 Mjetet mësimore

Për të zhvilluar temat e përsëritjes mësuesit dhe nxënësit do të bazohen në tekstet mësimore (nëse ekziston mundësia) të vitit të kaluar shkollor. Gjithashtu mësuesi mund të përdorë shënimet lidhur me njohuritë kryesore që do të zhvillohen në këto orë përsëritjeje dhe përforcimi.

## 2.6 Bashkëpunimi me prindërit

Shkollat kanë mundësi që në këtë moment unik të forcojnë marrëdhëniet e tyre me prindërit. Pavarësisht se përballen me sfida të rëndësishme, prindërit janë përfshirë më shumë se kurrë në procesin e të nxënësve të fëmijëve të tyre. Edhe gjatë vitit shkollor 2021-2022 prindërit do të jenë partnerë kritikë të shkollës për të ndihmuar nxënësit që të përsëritin dhe të përforcojnë njohuritë dhe aftësitë e lëndëve kryesore të vitit shkollor 2020-2021 dhe të nisin mbarë vitin e ri shkollor.

Mësuesit e lëndëve që do të zbatojnë temat e përsëritjes njoftojnë prindërit, lidhur me zhvillimin e temave të përsëritjes në lëndët “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj e parë”. Ata bashkëpunojnë me prindërit e nxënësve, lidhur me nevojat e nxënësve, mangësitë që kanë shfaqur ata gjatë vitit të kaluar dhe organizojnë punën e përbashkët për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në njohuritë kryesore të vitit të kaluar shkollor 2020 - 2021. Gjatë bashkëbisedimit me prindërit, mësuesit i sqarojnë ata për domosdoshmërinë, qëllimet dhe përmbajtjen kryesore të zhvillimit të temave të përsëritjes. Prindërit udhëzohen edhe se si mund të ndihmojnë fëmijët e tyre, në mënyrë që procesi i të nxënësve të vijojë edhe në shtëpi.

## **2.7 Temat e përsëritjes për nxënësit me aftësi të kufizuar**

Për zhvillimin e temave të përsëritjes me nxënësit me aftësi të kufizuar, mësuesi i lëndës në bashkëpunim me mësuesin ndihmës përcaktojnë nevojat e nxënësve për të përmirësuar rezultatet e tij. Mësuesi ndihmës në bashkëpunim me mësuesin e lëndës, psikologun dhe prindin harton një plan edukativ individual (PEI) të shkurtër për periudhën e përsëritjes.

## **2.8 Pagesa për mësuesit e gjuhës shqipe, matematikës dhe gjuhës së huaj të parë**

Mësuesit që do të zhvillojnë temat e përsëritjes do të paguhen me orë suplementare sipas një planifikimi të bërë nga drejtuesi i shkollës dhe të miratuar nga ZVA.

## **2.9 Monitorimi dhe raportimi i procesit të përsëritjes nga drejtoria e shkollës**

Procesi i zhvillimit të temave të përsëritjes nga mësuesit monitorohet nga drejtoria e shkollës. Ndërkohë ZVA-të, DRAP-et dhe DPAP-ja monitorojnë organizimin e gjithë procesit nga stafi drejtues dhe mësuesit, numrin e nxënësve pjesëmarrës për çdo klasë dhe për çdo lëndë, numrin e orëve suplementare që kanë zhvilluar mësuesit etj. Në përfundim të periudhës së përsëritjes, drejtoria e shkollës informon me një raport të shkurtër ZVA-në dhe DRAP-in, në lidhje me ecurinë e zbatimit të temave të përsëritjes

dhe numrin e nxënësve që e kanë ndjekur atë. DPAP-ja harton një raport përfundimtar për ecurinë e procesit.

# KRIJIMI I KLIMËS MBËSHTETËSE DHE BASHKËPUNUESE ME NXËNËSIT

## 3

Hapja e shkollave për vitin e ri shkollor nuk mjafton. Nxënësit do të kenë nevojë për të marrë shërbimet e nevojshme për të përmbushur të nxënit, shëndetin, mirëqenien psiko-sociale dhe mësim përforcues efektiv për t'i ndihmuar ata në rikuperimin e humbjeve të të nxënit.

Gjatë zbatimit të temave të përsëritjes, mësuesit duhet të mbajnë parasysh se nxënësit mund të ndihen ende të stresuar e të pasigurt për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, prandaj krijimi i klimës pozitive, mbështetëse dhe të sigurt do t'i ndihmojë ata ta kalojnë këtë periudhë “mësimi” në nivelin e dëshiruar, me një marrëdhënie të shëndetshme pranë mësuesit dhe nxënësve të tjerë të klasës. Nëse mësuesi ndien dhe kupton se ndonjë nxënës, me gjithë përpjekjet e bëra ende shfaq shenja izolimi dhe ankthi, atëherë duhet t'i drejtohet shërbimit psiko-social për ta ndihmuar sa më shpejt.

Në këtë kuadër, punonjësit e shërbimit psiko-social:

- bashkëpunojnë me mësuesit, mësuesit ndihmës, stafin mjekësor dhe oficerin e sigurisë për të ofruar mbështetje profesionale për nxënësit;
- hartojnë një plan për periudhën e përsëritjes, duke vlerësuar nevojat sociale dhe emocionale të nxënësve;
- bashkëpunojnë me stafin e shkollës për të zhvilluar veprimtaritë artistike dhe sportive;
- vëzhgojnë në mënyrë të vazhdueshme klasat për të monitoruar sjelljen e nxënësve nëse shfaqin shenja të stresit apo të ankthit;
- takohen me prindërit për të diskutuar nevojat e nxënësve;
- bashkëpunojnë me mësuesit ndihmës për hartimin e planeve edukative individuale për të përmbushur nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Gjatë kohës së mësimit *online*, mësuesi komunikonte me nxënësit në pjesën më të madhe të rasteve nëpërmjet telefonave dhe kompjuterëve të prindërve. Edhe në këtë rast ky bashkëpunim duhet të vijojë me qëllim zbutjen e pasojave të mbylljes dhe ruajtjen e shëndetit mendor të nxënësve.

Mësuesit dhe prindërit duhet t'u flasin fëmijëve për rëndësinë e jetës dhe se gjithsecili duhet ta ruajë veten, duke larë duart dhe duke ruajtur distancën. Gjithashtu, mësuesit dhe prindërit duhet të praktikojnë me fëmijët mënyra të reja të përshëndetjes pa u afruar dhe pa u prekur me njëri-tjetrin.

Orët për temat e përsëritjes në lëndët përkatëse duhet të ndërthuren me situata praktike, situata gazmore, veprimtari krijuese, biseda dhe diskutime, rrëfime personale, ngjarje dhe situata pozitive etj.

# METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E TEMAVE MËSIMORE PËR PËRSËRITJE

## 4

Gjatë zhvillimit të temave të përsëritjes, mësuesi duhet të bashkëveprojë me nxënësit gjatë procesit mësimor si kusht për arritjen e rezultateve të të nxënit, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në lëndët e gjuhës shqipe, në matematikë dhe në gjuhën e huaj të parë, mësuesi ka mundësi të përdorë metoda dhe teknika të larmishme mësimdhënieje, të cilat nxisin të menduarit dhe aftësitë krijuese të nxënësit. Në kushtet e zhvillimit të temave të përsëritjes, përdorimi i metodave dhe i teknikave të ndryshme:

- lehtëson të kuptuarit e përmbajtjes, të ideve dhe të zgjidhjeve;
- shërben për çdo formë të organizimit të orëve mësimore, si në punë individuale, ashtu edhe në punë në grup;
- i përfshin nxënësit në të gjitha proceset e të menduarit, nga njohja dhe të kuptuarit të gjërave në analizën, vlerësimin, argumentimin dhe mbajtjen e një qëndrimi të caktuar;
- u krijon mundësi nxënësve për fitimin e shprehive të zgjidhjes së problemeve;
- i aftëson në kryerjen e detyrave në mënyrë të pavarur.

Për zbatimin e këtyre metodave mësuesit mund të bazohen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë të hartuar dhe të publikuar nga ASCAP.

# FREKUENTIMI DHE VLERËSIMI I NXËNËSVE PËR TEMAT E PËRSËRITJES

## 5

### 5.1 Frekuentimi i nxënësve

Gjatë zhvillimit të temave të përsëritjes mësuesit mbajnë shënime për ndjekjen e orëve mësimore nga nxënësit dhe për numrin total të nxënësve që marrin pjesë në këto orë. Nxënësit janë të lirë të ndjekin ato lëndë që kanë më shumë nevojë ose të gjitha lëndët. Informacionin për frekuentimin e nxënësve mësuesit e dërgojnë në drejtorinë e shkollës.

### 5.2 Vlerësimi i nxënësve

Gjatë zhvillimit të temave të përsëritjes *nuk do të ketë vlerësim me notë të nxënësve*. Megjithatë gjatë këtij procesit mësimor, mësuesi do t'i motivojë nxënësit për të përmirësuar të nxënit e tyre duke identifikuar nevojat e mëtejshme për përmirësim dhe arritjet e nxënësve.

### 5.3 Dokumentacioni për zhvillimin e temave të përsëritjes

Shkollat janë të lira të përcaktojnë vetë një miniregjistër ku të shënojnë emrat e nxënësve që do të marrin pjesë në lëndët që zhvillojnë temat e përsëritjes, mungesat, temën e përsëritjes, si dhe ndonjë shënim për arritjet e nxënësve. Në përfundim të temave të përsëritjes, mësuesi e dorëzon këtë miniregjistër në drejtorinë e shkollës.



# TEMAT MËSIMORE TË PËRSËRITJES

## PËR SECILËN KLASË DHE LËNDË

### 6

#### 6.1 Klasa e gjashtë

##### Lënda: Gjuhë shqipe

Tekstet letrare dhe tekstet jo letrare përzgjidhen nga tekstet ose fragmentet që janë në librin e gjuhës shqipe me të cilin kanë punuar nxënësit. Në miniregjistër, te tema mësimore shtohet edhe titulli i tekstit ose i fragmentit.

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa V: <i>Të folurit</i> (Nxënësit diskutojnë në lidhje me një temë që është interesante për ta, si p.sh.: pushimet verore, filmat e preferuar, leximet gjatë pushimeve, lojërat që kanë luajtur gjatë pandemisë etj.).
2.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim etj.).
3.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim etj.).
4.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim etj.).
5.	Përsëritje nga klasa V: Analiza e personazheve duke u bazuar në fjalët, përshkrimet dhe veprimet e tyre.
6.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim etj.). Krahasimi dhe hiperbola.
7.	Përsëritje nga klasa V: Mbiemri. Përshtatja me emrin.
8.	Përsëritje nga klasa V: Përemrat vetorë. Trajtat e shkurtra.
9.	Përsëritje nga klasa V: Përemrat dëftorë. Përemrat pronorë. Përemrat pyetës.

10.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit e një teksti jo letrar.
11.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit e një teksti jo letrar.
12.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit e një teksti jo letrar. Tiparet kryesore të një letre.
13.	Përsëritje nga klasa V: Shkrimi i një letre drejtuar një shoku ose një të afërmi.
14.	Përsëritje nga klasa V: Shkrimi i një letre drejtuar një shoku ose një të afërmi.
15.	Përsëritje nga klasa V: Folja. Zgjedhimet.
16.	Përsëritje nga klasa V: Kohët e thjeshta të foljes në mënyrën dëftore.
17.	Përsëritje nga klasa V: Kryefjala dhe kallëzuesi.
18.	Përsëritje nga klasa V: Përcaktori.
19.	Përsëritje nga klasa V: Përdorimi i shenjave të pikësimit në fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore.
20.	Përsëritje nga klasa V: Fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike.

### Lënda: Matematikë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa V: Veprimi i mbledhjes dhe zbritjes me numra natyrorë.
2.	Përsëritje nga klasa V: Veprimi i shumëzimit dhe pjesëtimit me numra natyrorë.
3.	Përsëritje nga klasa V: Rrjeti koordinativ, simetria.
4.	Përsëritje nga klasa V: Paraqitja e të dhënave në tabelë.
5.	Përsëritje nga klasa V: Numrat dhjetorë me një dhe dy shifra pas presjes. Vendvlerat.
6.	Përsëritje nga klasa V: Veprimi i mbledhjes dhe i zbritjes së numrave dhjetorë me një shifër pas presjes.
7.	Përsëritje nga klasa V: Numrat thyesorë. Thyestat më të mëdha së 1.
8.	Përsëritje nga klasa V: Kthimi i thyesave në thyesa me emërues të njëjtë.
9.	Përsëritje nga klasa V: Thyesa si raport ose përpjesëtim i thjeshtë.
10.	Përsëritje nga klasa V: Shprehjet deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat.

11.	Përsëritje nga klasa V: Shprehjet deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat.
12.	Përsëritje nga klasa V: Perimetri i shumëkëndëshit të rregullt dhe jo të rregullt.
13.	Përsëritje nga klasa V: Formula për syprinën e drejtkëndëshit.
14.	Përsëritje nga klasa V: Kutiza si vendmbajtëse numrash në barazime me mbledhje të dy numrave me katër –pesë shifra.
15.	Përsëritje nga klasa V: Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie.
16.	Përsëritje nga klasa V: Mundësi që një ngjarje të ndodhë.

### Lënda: Gjuhë e huaj e parë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit - Ushtrime për të kuptuar një pjesë leximi.
2.	Përsëritje nga klasa V: Fjalori – Fjalë dhe shprehje që lidhen me jetën e përditshme në shkollë.
3.	Përsëritje nga klasa V: Gramatikë – Kohët e tashme të foljeve.
4.	Përsëritje nga klasa V: Të dëgjuarit- Lojëra dhe këngë.
5.	Përsëritje nga klasa V: Të folurit – Shkolla ime.
6.	Përsëritje nga klasa V: Të shkruarit – Shkruani një paragraf të shkurtër përshkrues (shoku/shoqja ime më e mirë).
7.	Përsëritje nga klasa V: Të lexuarit – Ushtrime për të kuptuar një paragraf përshkrues.
8.	Përsëritje nga klasa V: Fjalori – Fjalë dhe shprehje që lidhen me jetën e përditshme në familje.
9.	Përsëritje nga klasa V: Gramatikë – Ushtrime me kohët e tashme të foljeve.
10.	Përsëritje nga klasa V: Të dëgjuarit- Lojëra dhe këngë.
11.	Përsëritje nga klasa V: Të folurit – Familja ime.
12.	Përsëritje nga klasa V: Të shkruarit – Shkruani një paragraf të shkurtër përshkrues (shtëpia ime/dhoma ime).

## 6.2 Klasa e shtatë

### Lënda: Gjuhë shqipe

Tekstet letrare dhe tekstet jo letrare përzgjidhen nga tekstet ose fragmentet që janë në librin e gjuhës shqipe me të cilin kanë punuar nxënësit. Në miniregjistër, te tema mësimore shtohet edhe titulli i tekstit ose i fragmentit.

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VI: <i>Të folurit</i> (Nxënësit diskutojnë në lidhje me një temë që është interesante për ta, si p.sh.: pushimet verore, shoku/shoqja më e mirë gjatë pandemisë, leximet gjatë pushimeve, roli i teknologjisë për të mësuar; lojërat që kanë luajtur gjatë pandemisë etj.).
2.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim, tekst dramatik etj.).
3.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim, tekst dramatik etj.).
4.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim, tekst dramatik etj.).
5.	Përsëritje nga klasa VI: Shkrimi i një tregimi të shkurtër.
6.	Përsëritje nga klasa VI: Shkrimi i një tregimi të shkurtër.
7.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim, tekst dramatik etj.). Renditja e ngjarjeve në një tekst.
8.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, përrallë, tregim, tekst dramatik etj.). Personifikimi dhe aliteracioni.
9.	Përsëritje nga klasa VI: Klasat e fjalëve.
10.	Përsëritje nga klasa VI: Emri. Mbiemri.
11.	Përsëritje nga klasa VI: Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëftore dhe në mënyrën lidhore.
12.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti jo letrar.
13.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti jo letrar.

14.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit e një teksti jo letrar. Tiparet kryesore të një interviste.
15.	Përsëritje nga klasa VI: Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë.
16.	Përsëritje nga klasa VI: Gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë. Kryefjala dhe kallëzuesi.
17.	Përsëritje nga klasa VI: Ndajshtimi si një lloj përcaktori.
18.	Përsëritje nga klasa VI: Kundrinorët. Rrethanorët.
19.	Përsëritje nga klasa VI: Fjala dhe pjesët e saj përbërëse (rrënja, tema, parashtesa, prapashtesa dhe mbaresa).
20.	Përsëritje nga klasa VI: Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë zanoren <i>ë</i> në pozicione të ndryshme.

#### Lënda: Matematikë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VI: Faktorët për numrat dyshifrorë.
2.	Përsëritje nga klasa VI: Shumëfishi i përbashkët i dy numrave.
3.	Përsëritje nga klasa VI: Veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes me numrat thyesorë.
4.	Përsëritje nga klasa VI: Veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes me numrat dhjetorë.
5.	Përsëritje nga klasa VI: Kthimi i numrit dhjetor në thyesë dhe anasjelltas.
6.	Përsëritje nga klasa VI: Numrat e përzier dhe thyesat më të mëdha se 1.
7.	Përsëritje nga klasa VI: Kthimi i numrit të përzier në thyesë dhe anasjelltas.
8.	Përsëritje nga klasa VI: Njësitë e matjes së gjatësisë dhe masës.
9.	Përsëritje nga klasa VI: Këmbimi i njësive të matjes (kg me g; km, m, cm, mm) në numra dhjetorë deri në tri shifra pas presjes.
10.	Përsëritje nga klasa VI: Vargjet numerike me kufiza numra natyrorë, dhjetorë thyesorë.
11.	Përsëritje nga klasa VI: Përpunimi i të dhënave.
12.	Përsëritje nga klasa VI: Gjetja e përqindjes së një numri në ilustrime e situata praktike.

13.	Përsëritje nga klasa VI: Raporti dhe përpjesëtimi me anë të ilustrimeve dhe situatave nga jeta reale.
14.	Përsëritje nga klasa VI: Formula për perimetrin dhe syprinën e katrorit dhe drejtkëndëshit.
15.	Përsëritje nga klasa VI: Gjetja e koordinatave të një figure gjatë simetrisë, zhvendosjes.
16.	Përsëritje nga klasa VI: Përdorimi i shprehjeve: <i>ka mundësi, nuk ka mundësi, mbase, me siguri</i> dhe i të tjerave të ngjashme me to.

### Lënda: Gjuhë e huaj e parë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit – Gjetja e informacionit të detajuar në një pjesë të shkurtër leximi.
2.	Përsëritje nga klasa VI: Fjalori – Fjalë dhe shprehje që përdoren për të përshkruar rutinën e përditshme.
3.	Përsëritje nga klasa VI: Gramatikë – Kohët e tashme dhe të shkuara të foljeve.
4.	Përsëritje nga klasa VI: Gramatikë – Përemrat dëftorë dhe përemrat pronorë.
5.	Përsëritje nga klasa VI: Të dëgjuarit dhe të folurit – Familja ime, lagjja ime, koha e lirë.
6.	Përsëritje nga klasa VI: Të shkruarit- Shkruani një letër personale ku të përshkruani veten tuaj, vendin ku jetoni, dëshirat etj.
7.	Përsëritje nga klasa VI: Të lexuarit – Gjetja e informacionit të detajuar në një pjesë të shkurtër leximi me temë rreth pushimeve verore.
8.	Përsëritje nga klasa VI: Fjalori – Fjalë dhe shprehje që përdoren për të përshkruar pushimet verore.
9.	Përsëritje nga klasa VI: Gramatikë – Ushtrime rreth kohëve të shkuara të foljeve.
10.	Përsëritje nga klasa VI: Gramatikë – Shkalla krahasore e mbiemrave.
11.	Përsëritje nga klasa VI: Të dëgjuarit dhe të folurit – Pushimet verore.
12.	Përsëritje nga klasa VI: Të shkruarit- Shkruani një paragraf të shkurtër ku të përshkruani rutinën e përditshme në një ditë pushimi.

## 6.3 Klasa e tetë

### Lënda: Gjuhë shqipe

Tekstet letrare dhe tekstet jo letrare përzgjidhen nga tekstet ose fragmentet që janë në librin e gjuhës shqipe me të cilin kanë punuar nxënësit. Në miniregjistër, te tema mësimore shtohet edhe titulli i tekstit ose i fragmentit.

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VII: <i>Të folurit</i> (Nxënësit diskutojnë në lidhje me një temë që është interesante për ta, si p.sh.: çfarë kanë pasur të veçantë pushimet verore të këtij viti, komunikimi me shokët dhe shoqet gjatë pandemisë, librat që iu kanë pëlqyer më shumë, lojërat që kanë luajtur gjatë pandemisë etj.).
2.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.).
3.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.).
4.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit e një teksti letrar. Tema, ideja kryesore, subjekti.
5.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit e një teksti letrar. Llojet kryesore të strofave dhe të rimave.
6.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.). Metafora.
7.	Përsëritje nga klasa VII: Lakimi i emrave. Shkallët e mbiemrit.
8.	Përsëritje nga klasa VII: Zgjedhimi i foljeve sipas mënyrave dhe kohëve të tyre.
9.	Përsëritje nga klasa VII: Lidhëzat bashkërenditëse dhe lidhëzat nënrenditëse.
10.	Përsëritje nga klasa VII: Pjesorja dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes.
11.	Përsëritje nga klasa VII: Fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.
12.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit e një teksti jo letrar.
13.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit e një teksti jo letrar. Fakti dhe opinioni.
14.	Përsëritje nga klasa VII: Shkrimi i një eseje.

15.	Përsëritje nga klasa VII: Shkrimi i një eseje.
16.	Përsëritje nga klasa VII: Kallëzuesi i thjeshtë dhe kallëzuesi i përbërë.
17.	Përsëritje nga klasa VII: Llojet e rrethanorëve.
18.	Përsëritje nga klasa VII: Fjalitë e përbërë me bashkërenditje.
19.	Përsëritje nga klasa VII: Fjalitë e përbërë me nënrenditje.
20.	Përsëritje nga klasa VII: Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë.

### Lënda: Matematikë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VII: Shumëfishat, faktorët, shumëfishat e përbashkët, numrat e thjeshtë (të gjitha deri në 100).
2.	Përsëritje nga klasa VII: Mbledhja dhe zbritja e numrave të plotë, dhjetorë, thyesorë.
3.	Përsëritje nga klasa VII: Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave të plotë, dhjetorë.
4.	Përsëritje nga klasa VII: Shprehjet shkronjore.
5.	Përsëritje nga klasa VII: Përdorimi i shkronjave për të zëvendësuar numrat.
6.	Përsëritje nga klasa VII: Thjeshtimi dhe zbërthimi i shprehjeve algjebrike.
7.	Përsëritje nga klasa VII: Perimetri dhe syprina e drejtkëndëshit.
8.	Përsëritje nga klasa VII: Perimetri dhe syprina e figurave të përbëra nga drejtkëndësha.
9.	Përsëritje nga klasa VII: Ekuacionet me një veprim.
10.	Përsëritje nga klasa VII: Ekuacionet me dy veprime.
11.	Përsëritje nga klasa VII: Lidhja e thyesave me numrat dhjetorë dhe përqindjen.
12.	Përsëritje nga klasa VII: Raporti dhe përpjesëtimi.
13.	Përsëritje nga klasa VII: Funkzioni. Grafiku i funksionit.
14.	Përsëritje nga klasa VII: Përzgjedhja dhe grumbullimi i të dhënave.
15.	Përsëritje nga klasa VII: Tabela e dendurive për të dhënat e vazhdueshme.
16.	Përsëritje nga klasa VII: Probabiliteti i ngjarjes së thjeshtë me rezultate të barasmundshme.



## Lënda: Gjuhë e huaj e parë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit – Gjetja e idesë kryesore dhe e detajeve në një pjesë leximi.
2.	Përsëritje nga klasa VII: Fjalori – Fjalë dhe shprehje që lidhen me ambientin ku jetojmë.
3.	Përsëritje nga klasa VII: Gramatikë – Kohët e shkuara të foljeve.
4.	Përsëritje nga klasa VII: Gramatikë – Emrat.
5.	Përsëritje nga klasa VII: Të dëgjuarit dhe të folurit – Përdorimi i teknologjisë në jetën e përditshme.
6.	Përsëritje nga klasa VII: Të shkruarit Shkruani një letër për shokun/shoqen tuaj ku të përshkruani se si i kaluat pushimet verore.
7.	Përsëritje nga klasa VII: Të lexuarit – Ushtrime me pyetje të hapura për gjetjen e idesë kryesore në një pjesë leximi me temë nga jeta e përditshme.
8.	Përsëritje nga klasa VII: Fjalori – Fjalë dhe shprehje në lidhje me sportet që praktikojnë adoleshentët.
9.	Përsëritje nga klasa VII: Gramatikë – Rendi i fjalëve në fjali.
10.	Përsëritje nga klasa VII: Gramatikë – Shkallët e mbiemrave.
11.	Përsëritje nga klasa VII: Të dëgjuarit dhe të folurit – Sporti dhe sportisti im i preferuar.
12.	Përsëritje nga klasa VII: Të shkruarit – Shkruani një paragraf për jetën e sportistit tuaj të preferuar.

## 6.4 Klasa e nëntë

### Lënda: Gjuhë shqipe

Tekstet letrare dhe tekstet jo letrare përzgjidhen nga tekstet ose fragmentet që janë në librin e gjuhës shqipe me të cilin kanë punuar nxënësit. Në miniregjistër, te tema mësimore shtohet edhe titulli i tekstit ose i fragmentit.

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VIII: <i>Të folurit</i> (Nxënësit diskutojnë në lidhje me një temë që është interesante për ta, si p.sh.: çfarë kanë pasur të veçantë pushimet verore të këtij viti, komunikimi me shokët dhe shoqet gjatë pandemisë, librat që iu kanë pëlqyer më shumë, objektivat që kanë për vitin e ri shkollor etj.).
2.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.).
3.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.).
4.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.).
5.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.).
6.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti letrar (poezi, prozë, tekst dramatik etj.).
7.	Përsëritje nga klasa VIII: Kuptimi i parë dhe i figurshëm i fjalëve.
8.	Përsëritje nga klasa VIII: Gjuha standarde dhe dialektet.
9.	Përsëritje nga klasa VIII: Regjistrat e gjuhës.
10.	Përsëritje nga klasa VIII: Fjalëformimi (Analiza e fjalëve sipas ndërtimit dhe kuptimit).
11.	Përsëritje nga klasa VIII: Zgjedhimi jo vepror i foljeve.
12.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti jo letrar, si p.sh.: biografi, kujtime, intervista, rregullore, kronika, ese, reklama etj.
13.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti jo letrar, si p.sh.: biografi, kujtime, intervista, rregullore, kronika, ese, reklama etj.
14.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit e një teksti jo letrar, si p.sh.: biografi, kujtime, intervista, rregullore, kronika, ese, reklama etj.
15.	Përsëritje nga klasa VIII: Shkrimi i një eseje argumentuese.
16.	Përsëritje nga klasa VIII: Shkrimi i një eseje argumentuese.
17.	Përsëritje nga klasa VIII: Llojet e kallëzuesit.
18.	Përsëritje nga klasa VIII: Fjalitë e përbëra me nënrenditje.

19.	Përsëritje nga klasa VIII: Kthimi i ligjëratës së drejtë në ligjëratë të zhdrejtë.
20.	Përsëritje nga klasa VIII: Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit.

### Lënda: Matematikë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VIII: Pjesëtuesi më i madh i përbashkët dhe shumëfishi më i vogël i përbashkët.
2.	Përsëritje nga klasa VIII: Fuqitë me eksponent 2 dhe 3. Rrënja katrore dhe kubike.
3.	Përsëritje nga klasa VIII: Renditja e thyesave duke gjetur emëruesin e përbashkët ose duke i kthyer në numra dhjetorë.
4.	Përsëritje nga klasa VIII: Radha e veprimeve aritmetike në shprehjen me dhe pa kllapa.
5.	Përsëritje nga klasa VIII: Përqindja, rritja dhe ulja e përqindjes.
6.	Përsëritje nga klasa VIII: Njësitë e gjatësisë dhe të masës.
7.	Përsëritje nga klasa VIII: Formulatat për perimetrin dhe syprinën e rrethit.
8.	Përsëritje nga klasa VIII: Sipërfaqe për figurat e përbëra 2D.
9.	Përsëritje nga klasa VIII: Shumëzimi dhe reduktimi i monomeve të ngjashme.
10.	Përsëritje nga klasa VIII: Zbërthimi i shprehjeve algjebrike. Reduktimi i kufizave të ngjashme.
11.	Përsëritje nga klasa VIII: Drejtëza paralele, prerëse, pingule. Kënde në drejtëza paralele.
12.	Përsëritje nga klasa VIII: Kongruenca e segmenteve dhe këndeve dhe e trekëndëshave.
13.	Përsëritje nga klasa VIII: Funkzioni.
14.	Përsëritje nga klasa VIII: Ekuacioni i drejtëzës.
15.	Përsëritje nga klasa VIII: Mesorja, moda dhe mesatarja aritmetike për të dhënat diskrete dhe të vazhdueshme.
16.	Përsëritje nga klasa VIII: Probabiliteti me formulë. Probabiliteti eksperimental.

## Lënda: Gjuhë e huaj e parë

NR.	TEMAT MËSIMORE
1.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit - Gjetja e idesë kryesore dhe e detajeve në një pjesë leximi.
2.	Përsëritje nga klasa VIII: Fjalori – Ushtrime me fjalorin në situata të jetës reale.
3.	Përsëritje nga klasa VIII: Gramatikë – Kohët e foljeve të rregullta dhe jo të rregullta. Ushtrime nga situata të jetës së përditshme.
4.	Përsëritje nga klasa VIII: Gramatikë – Fjalitë kushtore. Ushtrime.
5.	Përsëritje nga klasa VIII: Të dëgjuarit dhe të folurit – Ngjarje në të tashmen dhe në të shkuarën.
6.	Përsëritje nga klasa VIII: Të shkruarit – Shkruani një tregim për një ngjarje që ka ndodhur në të shkuarën.
7.	Përsëritje nga klasa VIII: Të lexuarit – Të kuptuarit e një teksti letrar. Ushtrime me pyetje dhe përgjigje të hapura.
8.	Përsëritje nga klasa VIII: Fjalori – Gjetja e kuptimit të fjalëve nga konteksti.
9.	Përsëritje nga klasa VIII: Gramatikë – Fjalitë jo veprare.
10.	Përsëritje nga klasa VIII: Gramatikë – Ushtrime me foljet jo veprare në situata të jetës së përditshme.
11.	Përsëritje nga klasa VIII: Të dëgjuarit dhe të folurit – Dita më e bukur e jetës sime.
12.	Përsëritje nga klasa VIII: Të shkruarit – Ajo ishte dita më e bukur/ më e vështirë e jetës sime.

# PLANIFIKIMI I KURRIKULËS PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022

## 7

Temat mësimore për përsëritje nuk do të jenë pjesë e planeve të mësuesit për vitin shkollor 2021-2022. Viti i ri shkollor 2021 – 2022 fillon me programin lëndor për klasën përkatëse. *Plani vjetor dhe temat e të tria periudhave do të vijojnë të planifikohen nga vetë mësuesit.* Procedura për hartimin dhe për dorëzimin e planeve vjetore dhe të periudhave do të jetë njësoj siç është parashikuar në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

Edhe gjatë vitit shkollor 2021 – 2022, planifikimi i mësimdhënies për lëndën përfshin:

- planifikimin vjetor;
- planifikimin për secilën periudhë;
- planifikimin ditor.

Në fillim të vitit shkollor mësuesi do të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore (plan sintetik), si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor) sipas rubrikave më poshtë:

- *Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç*
- *Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave lëndore*
- *Numri rendor*
- *Kapitulli/ tematika/ kompetenca*
- *Tema mësimore*
- *Situata e të nxënit*
- *Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve*
- *Vlerësimi*
- *Burimet e të nxënit*

Planet e periudhës së dytë dhe planet e periudhës së tretë do të dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te rezultatet e kompetencave kyç dhe të lëndës.

Edhe gjatë vijimit të vitit shkollor mund të zhvillohet punë e diferencuar me nxënësit që ende kanë nevojë për mbështetje dhe përmirësim të arritjeve të tyre si pasojë e mangësive të krijuara nga pandemia COVID-19.

# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



[sekretaria@ascap.edu.l](mailto:sekretaria@ascap.edu.l)



[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar